



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1034/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Hunaida Pasuli- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses SH.G. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Y.B. nga Prishtina, pronar në zyrën juridike B..., kundër të paditurës R..., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson O.S. nga Prishtina, me bazë juridike kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3134/2011, të datës 04.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **24.02.2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës R..., me seli në Prishtinë, ndërsa pika I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3134/11, të datës 04.01.2017, në pjesën që ka të bëjë me aprovimin e pjesëm të kërkesëpadisë së paditëses SH.G., për kompensimin e dëmit jo material, në emër të kufizimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si dhe pika III, që ka të bëjë me shpenzimet procedurale, **VËRTETOHEN**, përveç pjesës së kamatës, e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet me kamatë ligjore, sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës, në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive.

II. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës R..., me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3134/11, në pikën I të dispozitivit, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material, në emër të dhimbjeve fizike, frikës dhe shëmtimit trupor dhe çështja gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura R..., me seli në Prishtinë, që paditëses SH.G. nga Prishtina, në emër të dëmit jo material, t’ia kompensojë shumat si në vijim: për dhimbje fizike, shumën prej 3,500 €, për frikë, shumën prej 3,200 € dhe për shëmtim trupor, shumën prej 1,200 €, me kamatë ligjore, sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës, në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses SH.G. nga Prishtina, nga shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike, frikë dhe shëmtim, e deri tek shumat e kërkuara për to, **REFUZOHET** si e pathemeltë.

IV. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3134/11, i datës 04.01.2017, që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditëses, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.3134/11, të datës 04.01.2017, në pikën e parë ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses SH.G. nga Prishtina, detyrohet e paditura R...-Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit, për lëndimin e pësuar në vendin e punës të datës 06.02.2012, për 70% të përgjegjësisë t'i paguaj shumat e specifikuar për dëmin material: kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 7.000 €, kompensim në emër të frikës shumën prej 8.400 €, kompensim në emër të shëmtimit trupor shumën prej 2.450 €, kompensim në emër të kufizimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 1.050 € prej 3.500 €. Në pikën e dytë të dispozitivit, gjykata ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditëses kundër të paditurës përtej shumave të gjykuara si më lartë, si të pa bazuar. Në pikën e tretë, detyrohet e paditura që paditëses pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'i paguaj edhe kamatën vjetore ligjore, dukë filluar nga data.04.01.2017e deri në pagesën e plote si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,750.00 €, e të gjitha kërkesat në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zabtimit të gabuar të së drejtës materiale. Me këtë ankesë, e paditura ka kërkuar nga Gjykata e Apelit që të prishë në tërësi aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është **pjesërisht e themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit jomaterial në shumat e kërkuara (si në shkresat e lëndës) për lëndimet e shkaktuara me rastin e aksidentit të shkaktuar me datë 06.02.2012.

Duke vepruar sipas kësaj padie, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën kontestimore në të cilën ka administruar dhe shqyrtuar provat: kontrata e punës e datës

01.03.2011 nr.9876/0, konfirmimi i transkcionit i lëshuar nga e paditura, i datës 18.11.2011, çertifikata e transferimit e datës 21.12.2005, fletëlëshimi i lëshuar nga ambulanca specialistike ortopedike AS, i datës 06.12.2011, raporti i radiologut specialistik, i datës 18.11.2011, ekspertiza e lëmisë së mbrojtjes në punë e datës 19.07.2015, ekspertizat mjekësore të datës 27.06.2016 dhe fotot ku ka ndodhur lëndimi në punë, e në bazë të këtyre, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se vendimin e marrë e ka mbështetur ne provat e administruara dhe neni 8 të LPK-së, neni 173, 174, 192 par. 1, 186, 277, 200 të LMD-së. Vendimet për shpenzimet e procedurës gjykata e ka bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat i njëjti është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, përveç pjesës së ndryshuar, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe ajo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Refuzohen si të paqëndrueshme pretendimet ankimore të palës së paditur, që atakojnë vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë, meqënëse, ashtu siç rezulton nga shkresat e lëndës, si dhe arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e atakuar, një bazë e tillë, është vërtetuar në bazë të provave adekuate, konkretisht, me anë të ekspertizës së mbrojtjes në punë, të datës 19.07.2015, të punuar nga eksperti H.N., e cila gjendet në shkresat e lëndës, e cila është sqaruar siç duhet edhe në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, sa i përket përfundimit të nxjerrë lidhur me përgjegjësinë objektive në shkallën prej 70% të së paditurës (*sipas nenit 154 parag.2 dhe 3 të LMD-së që ka qenë në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit në punë*). Një ekspertizë të tillë, gjykata e shkallës së parë e ka caktuar në pajtim me dispozitat e nenit 356 (e më tutje), të LPK-së dhe të thënat në të, janë marrë si të mirëqena nga gjykata, sipas bindjes së lirë, vlerësim ky, që në mungesë edhe të ndonjë prove apo konstatimi tjetër profesional që do ta përjashtonte tërësisht përgjegjësinë objektive të paditurës për incidentin e ndodhur, vlerësohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë.

Ndërsa, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, Gjykata e Apelit i refuzon pretendimet ankimore të së paditurës, sa i përket atakimit të shumës së kompensimit të dëmit jo material, në emër të kufizimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në vlerë prej 1,050 €, e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, meqë duke marrë parasysh shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të tillë (15%), një shumë e tillë, nuk konsiderohet e lartë e as e dëmshme për të paditurën. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë edhe e ka zvogëluar një shumë të tillë, nga ajo që ka kërkuar pala paditëse (1,500€), veprim ky që çon drejt vërtetimit të një vlerësimi të kujdesshëm e të drejtë që është bërë nga gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të kësaj shume. Sa i përket kësaj pjese të dispozitivit, është evidentuar se shuma prej 3,500 €, e përmendur nga

gjkata e shkallës së parë, për këtë formë të dëmit, paraqitet si gabim teknik i gjykatës, më konkretisht, është dashur të jetë shuma prej 1,500 €, e cila është kërkuar nga paditësi, ashtu siç shihet edhe në precizimin e kërkesëpadisë të bërë më 14.12.2016 (në shkresa të lëndës), si dhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit. Kështu, gabimisht është kuptuar nga pala e paditur se gjykata e shkallës së parë nuk ka hequr nga shuma e kompensimit me të cilën është obliguar e paditura, 30 përqindëshin e përgjegjësisë së palës paditëse, e meqë është evidentuar se një paqartësi e tillë nuk është diçka që nuk mund të ekzaminohet apo të qartësohet nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë, e njëjta nuk ka pasur ndonjë ndikim të veçantë në vendosjen ndryshe për këtë pjesë të vendimit të marrë në shkallë të parë lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë.

Në anën tjetër, edhe pse shumat e vendosura nga gjykata e shkallës së parë i përgjigjen shkallës 70% të përgjegjësisë së të paditurës, në raport me lartësinë e kërkesëpadisë së paditëses, si rrjedhojë e sqarimit të mësipërm, të njëjtat, prapë se prapë, konsiderohen nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë, si më të larta se sa që do të duhej të ishin, në raport me atë që kërkojnë dispozitat ligjore, përkatësisht neni 192 i LMD-së, që ka të bëjë me kontributin e të dëmtuarit në shkaktimin e aksidentit. Në këtë kuptim, sa i përket ankesës së palës së paditur lidhur me shumat e kompensimit për dhimbjet fizike, frikën dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit e aprovoi atë, pjesërisht si të bazuar, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë. Në këtë pikë, Gjykata e Apelit i ndryshoi shumat e kompensimit të gjykuara për këto forma të dëmit, pasi që të njëjtat, janë vlerësuar si shumë të larta, për të përmbushur qëllimin e satisfacionit material të palës së dëmtuar. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë nuk është mbështetur siç duhet në nenin 200.2 të LMD-së, të aplikueshëm në kohën e ndodhjes së lëndimit (2011), i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Marrë këtë parasysh, Gjykata e Apelit i vendosi shumat e kompensimit për këto forma të dëmit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në kriteret e zbatueshme për vlerësim, si dhe në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës, për këto forma të shpërblimit të dëmit. Duke u mbështetur në nenin 200 të LMD-së, këto shuma të vendosura tani, përfaqësojnë një satisfacion adekuat që pala e dëmtuar t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit, nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen realisht me para, por të paktën, mund të bëhet kompensimi i ligjshëm i tyre. Për këtë arsye, është refuzuar si e pathemeltë edhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses SH.G., nga shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike, frikë

dhe shëmtim trupor, e deri tek shumat e kërkuara për to, sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet procedurale, konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga kjo Gjykatë e shkallës së dytë, meqë i njëjti, është marrë konform nenit 452.2 të LPK-së, që thotë se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*. Sipas kësaj dispozite, është në diskrecionin e gjykatës që të vendosë nëse secila palë do t’i bartë shpenzimet e veta apo njëra do t’ia shpërblejë shpenzimet tjetrës, edhe atëherë kur njëra palë ka pasur pjesërisht sukses në kontest, si në këtë rast. Ndërsa, pjesën e kamatës është ndryshuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e Ligjit të vjetër të Detyrimeve (nenit 277), të aplikueshme në kohën e ndodhjes së aksidentit (2011).

Si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit ka vendosur meqënëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka parashtruar pretendime ankimore sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditëses, andaj edhe kjo pjesë ka mbetur e pashqyrtuar.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1034/17, datë 24.02.2020

**Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka**